



KOMISIONI KOMUNAL I AKSIONARËVE I N.P.L "PËRPARIMI" SH. A NË VUSHTRRI

Në mbështetje të nenit 5.2, dhe nenit 7, nenit 16 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 15.06.2008, nenit 164, dhe nenit 182 nën par. 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare të shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 24.05.2018, dhe nenit 16 nën par. 1.1 dhe nenit 17 të Statutit Nr. 252/22, të N.P.L "Përparimi" Sh. A. të miratuar me datë 14.10.2022, nga Komisioni Komunal i Aksionarëve, lidhur me Konkursin Publik të shpallur nga Komuna e Vushtrrisë me datë 11.01.2023 me nr. të protokollit 06/23 lidhur me përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve, Komisioni Komunal i Aksionarëve të N.P.L "Përparimi" Sh. A në përbërje prej 1. Qemajl Hasani – Kryesues i Komisionit, 2. Agim Bregaj – Anëtar i Komisionit dhe 3. Mensur Kasumi – Anëtar i Komisionit në mbledhjen e mbajtur me datë 24.10.2024, nxjerrin këtë:

VENDIM

(Për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve të N.P.L "Përparimi" Sh. A)

1. Pas zhvillimit të të gjitha fazave të procedurave të rekrutimit, dhe rezultateve të arritura nga intervista me gojë, Komisioni Komunal i Aksionarëve nga 300 pikët e mundshme për kandidatët që janë intervistuar për anëtarë të Bordit të Drejtorëve të N.P.L "Përparimi" Sh. A, ka ndarë këto pikë si në vijim:

| Nr. | Kandidati dhe nr. protokoli | Pikët e mundshme | Nr. i pikëve |
|-----|-----------------------------|------------------|-------------------|
| 1. | Arsim Rashiti 112/24 | (300 pikë) | 98 |
| 2. | Eroll Venhari 111/24 | (300 pikë) | Nuk ka marr pjesë |
| | | | |

2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e Kryesuesit të Komisionit Komunal të Aksionarëve.

Arsyetim

Ky vendim është marr nga ana e Komisionit Komunal të Aksionarëve të cilët kanë arritur në këtë përfundim pas vlerësimit të intervistës me gojë.

Me datë 06.09.2024 është shpallur konkursi publik për përzgjedhjen e një (1) anëtarë të Bordit të Drejtorëve, ku periudha e aplikimit ka qenë e hapur prej tridhjetë (30) ditë kalendarike dhe atë nga data 06.09.2024 deri me datë 05.10.2024 në ora 16:00.

Për t'u përzgjedhur për Anëtarë të Bordit të Drejtorëve kanë aplikuar 3(tre) kandidatë. Nga ta kanë plotësuar kushtet që të marrin pjesë në procedurat e mëtutjeshme vetëm dy (2) kandidatë:

1. **Arsim Rashiti** Nr. protokolli 112/24 dhe
2. **Eroll Venhari** Nr. protokolli 111/24

Kandidati/ja i/e cili nuk i ka plotësuar kushtet e parapara ligjore për të marr pjesë për intervistim, znj **Shqiponjë Mikushnica** Nr. protokoli 110/24, i është dhënë mundësia që nga dita e njoftimit për kandidatët që plotësojnë kushtet e konkursit publik, në afat prej (3) ditësh të parashtrajnë vërejtje në lidhje me përpilimin e listës nga ana e Komisionit Komunal të Aksionarëve. Pas kalimit të afatit prej tre (3) ditë, kandidatët të cilët kanë plotësuar kushtet e konkursit publik janë njoftuar në lidhje me datën dhe orën se kur do të mbahet intervistimi me gojë, dhe atë janë njoftuar me anë të e-mail adresës, gjë që të njëjtit e kanë konfirmuar pjesëmarrjen.

Pas zhvillimit të t'gjitha fazave të procedurave të rekrutimit, kandidatët në bazë të pikëve të fituara nga intervista me gojë, Komisioni Komunal i Aksionarëve konkludon se kandidatët nuk kanë arritur pikët e mjaftueshme për t'u përzgjedhur për anëtarë të Bordit të Drejtorëve.

Këshilla Juridike: *Kandidatët të cilët nuk pajtohen me këtë Vendim të Komisionit Komunal të Aksionarëve, kanë të drejtën të parashtrajnë padi në Gjykatën kompetente brenda afatit tridhjetë (30) ditë nga dita e publikimit të njoftimit.*

1. 
Kryesues i KKA
Qemajl Hasani

Vendimi u dërgohet:

- Kryeshefit Ekzekutiv të N.P.L "Përparimi" Sh. A;
- Sekretarisë së Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë;
- Zyrës së Arkivës së Komunës;